



NJOFTIM

SHPALLJE PUBLIKE PËR QIRADHËNIE

Njësia Nr.	Emri i Ndërmarrjes Shoqërore	Emërtimi i Asetit	Vendndodhja e asetit/pronës (Adresa)	Sipërfaqja m ²
Njësia 1	NSH "Metaliku"	Objekti depo e prodhimeve të gatshme-fabrika e telit	Rr. Gjergj Karaqi p.n Gjakovë	2526m ²

Kushtet e përgjithshme:

1. Periudha e Qiradhënies është për 1 vit me mundësi vazhdimi;
2. Ofertat duhet të dorëzohen personalisht apo në rast që dorëzohen në emër të qiramarrësit pala duhet ta ketë autorizimin e noterizuar tek noteri.
3. Ofertat duhet të dorëzohen në zarf të mbyllur (një zarf – një ofertë për një njësi), dorëzohen në Zyrën Qendrore të AKP-së.
4. Në zarf (jashtë) duhet të specifikohet: nr i Njesisë, emri i NSH-së, Emërtimi i Asetit dhe vendndodhja e asetit.
5. Në rastet e qiradhënies në vlera mbi € 1,000 mujore, para nënshkrimit të kontratës do të kërkohet nga ofertuesi fitues të sjellë garancionin bankar (jo letër zotimi nga banka) në lartësinë e kontratës.
6. Për dorëzimin e ofertës duhet te përdoret **Formulari për Dorëzimin e Ofertës** i cili mund të merret në Zyrën Qendrore të AKP-së-Njësia për Monitorim, Kontroll dhe Administrim Direkt, apo të shkarkohet nga ueb-faqja: www.pak-ks.org
7. Kriteri për përzgjedhjen e ofertuesit fitues të njësive përkatëse do të jetë çmimi i ofertës më të lartë.
8. Ofertat do të pranohen me datë **31.03.2023** prej orës 13:00 – 14:00 në zarf të mbyllur.
9. Zarfet do të hapen publikisht në Zyrën Qendrore të AKP-së me datë **31.03.2023** në ora 14:15
10. Ofertat përmes faksit nuk do të pranohen.
11. Palët e interesuara për shikimin fizik të aseteve mund ta kontaktojnë Menaxherin e Ndërmarrjes-Isa Zymberi të cilin mund ta kontaktojnë në nr. tel 044/123-251.
12. Kjo shpallje përpos që do të publikohet në media do të publikohet edhe në ueb faqen zyrtare të AKP-së.
13. Në çmimin e ofertës totale duhet të përfshihen të gjitha tatimet e aplikueshme në Kosovë, (përfshirë edhe TVSH 18%, etj.)
14. Në ato raste kur ekzistojnë dy oferta të njëjta, çështja rregullohet që ofertuesi i parë për nga koha, ka përparësi.

Pagesa e Qiramarrjes:

Ofertuesit fitues është i obliguar që të paguaj shumat me pagesa të rregullta paraprake mujore, duke filluar me pagesën e parë të caktuar në fillimin e kësaj Kontrate të Qirasë, dhe, deri në masën që është e zbatueshme, me pagesa mujore në vijim, të caktuara në të njëjtën ditë të muajit vijues, (apo më herët në rast se data e pagesës së parë apo ndonjë pagesë tjetër mujore rastis të jetë ndonjë festë publike).

Dispozita të përgjithshme:

Prona/aseti i Ndërmarrjes Metaliku, paraqitur si më lartë ofrohet për qiradhënie “ashtu siç është” dhe “ku është”. Ofertuesit kanë përgjegjësinë të verifikojnë përshkrimin dhe kushtet e njësisë/depon e prodhimeve të gatshme (gjendjen faktike) dhe AKP do të konsiderojë se ofertuesit kanë dijeni të mjaftueshme në lidhje me pronën e ofruara për qiradhënie dhe nuk do të jenë përgjegjës për ndonjë pengim të posedimit/shfrytëzimit eventual.

Ofertuesit me ndalesë ofertimi:

- Personat fizik apo juridik të cilët kanë uzurpuar paluajtshmërinë në pronësi shoqërore, ndaj të cilëve Agjencia apo NSH -ja ka iniciuar procedurë gjyqësore për lirimin e pronës dhe kompensimin e dëmeve eventuale;
- Personat fizik dhe juridik që: (i) nuk i kanë respektuar kushtet e ndonjë kontrate të lidhur me Agjencinë ose me çfarëdo ndërmarrje që administrohet nga Agjencia (ekzistenca dhe natyra e atij mosrespektimi do të përcaktohet nga Agjencia sipas zgjedhjes së saj), (ii) kanë borxh ose gjobë të pashlyer ndaj Agjencisë ose ndonjë ndërmarrje që administrohet nga Agjencia, (iii) personat fizik ose juridik të cilët nuk kanë paguar gjobat e caktuara nga Agjencia ose që i nënshtrohen ndonjë kërkesëpadie ose kontesti (pa marrë parasysh nëse çështja e tillë është ngritur në gjykatë apo tjetërkund).

Ofertat do të pranohen me 31.03.2023 prej orës 13:00 – 14:00 në zarf të mbyllur në:

Zyra Qendrore e AKP-së në Prishtinë; Adresa: Rr. Dritan Hoxha, Nr. 55 Lakrishtë, 10000 Prishtinë

Tel: 038/500-400 lok. 1130; email: info@pak-ks.org; www.pak-ks.org